



REPUBLIKA E SHQIPERISE

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

MIDIS

**ORGANIT KOMBËTAR TË INVESTIGIMEVE TË INCIDENTEVE DHE
AKSIDENTEVE AJRORE NË AVIACIONIN CIVIL TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË**

DHE

**INSTITUTIT TË MJEKËSISË LIGJORE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
LIDHUR ME**

**BASHKËPUNIMIN DHE ASISTENCËN NË RASTIN E NJË
INCIDENTI/AKSIDENTI TË RËNDË NË FUSHËN E AVIACIONIT CIVIL**

1. FJALORI

AC – Aviacioni Civil

IND – Investigatori Në Detyrë

IML – Instituti i Mjekësisë Ligjore

EML – Ekspert Mjeko Ligjor

MB – Memorandum Bashkëpunimi

RSH- Republika e Shqipërisë

OBR – On-Board Recording

OKIIA – Organi Kombëtar i Investigimit të Incidenteve/Aksidenteve



2. HYRJE

2.1 Ky Mermorandum Mirëkuptimi shpreh mirëkuptimin e OKIIA dhe IML, të cilave më pas do ti referohemi si Palët në këtë MB, lidhur me kooperimin dhe asistencën në rastin e një incidenti/aksidenti të rëndë në fushën e AC.

2.2 Dihet se të dy Palët i përgjigjen ligjeve të RSH-së dhe për këtë arsye ata janë të lidhur nga standardet e përfshira në këtë legjislacion (Kodi Aviacionit Civil.).

2.3 Kjo MB përcakton masat procedurale për bashkëpunim dhe asistencë midis Palëve në përputhje me legjislacionin e RSH.

3. TERMINOLOGJIA

3.1 Fjalët dhe frazat e përdorura në këtë dokument, kanë të njëjtin kuptim ashtu si përkruhet në legjislacionin e RSH.

4. QËLLIMI

4.1 Qëllimi i kësaj MB është rritja e efikasitetit në kryerjen e detyrës për të dy Palëve, në rast të një incidenti/aksidenti të rëndë duke:

a) njohur ngjashmërinë e qëllimit të OKIIA dhe IML për të përmirësuar sigurinë e popullsisë dhe në të njëjtën kohë duke pranuar metodat të ndryshme që Palët përdorin për t'ia arritur këtij qëllimi

b) minimizuar dyfishimin e mundimit dhe shmangien e një konflikti të mundshëm pa çenuar pavarësinë dhe funksionin e Palëve dhe për të inkurajuar një atmosferë konsultimi dhe bashkëpunimi për të siguruar që Palët të jenë të afta të kryejnë një investigim të saktë, konform legjislacionit në vend.

4.2 OKIIA dhe IML pranojnë se kjo MB nuk kufizon diskrecionin dhe kompetencat e secilës palë bazuar në legjislacion.

4.3 Nuk është qëllimi i palëve në këtë MB të krijojë detyrime ligjore ndërmjet Palëve përveç atyre të parashtruara në këtë MB .

5. MIRËKUPTIMI I NDËRSJELLË

5.1 OKIIA pranon rolin e rëndësishëm të IML në interesin publik dhe nevojën e MLP që të jetë në gjendje të testoj çdo provë që vjen para tij në mënyrë të drejtë dhe të paanshme, në përputhje me e rolin e tij legjitim sipas legjislacionit të RSH-së.

5.2 IML pranon rolin e rëndësishëm të OKIIA në interesin publik , bazuar në legjislacionin e RSH-së dhe nevojën e IND që të përdorë buxhetin e kufizuar të OKIIA për të hetuar çështjet e sigurisë së transportit konformë legjislacionit.

5.4 Secila palë duhet të krijojë një grup pune për të dhënë kontributin e tyre në fushën e investigimit të incidenteve/aksidenteve në AC. Këto shkëmbime teknike do të përfshijnë



diskutime që synojnë thellimin e njohjes së aftësive investigative të Palëve, si dhe qëllimin e shtrirjes së çdo ndihme që mund të sigurohet në kushte të caktuara, pa cënuar hetimin e institucioneve përkatëse sipas legjislacionit ne fuqi.

5.5 Shkëmbimi i bashkëpunimit midis palëve duhet të mbuloj gjithashtu edhe trajnim të përshtatshëm për stafin e dy institucioneve sipas fushave përkatëse, duke përfshirë këtu edhe pjesëmarrjen në kurse trajnimi.

6. ROLET DHE PËRGJEGJËSITË

6.1 OKIIA do të njoftojë IML sa më shpejt të jetë e mundur, pasi të jetë marrë një vendim nga organet kompetente (prokuroria) nëse është nisur apo është ndërprerë një hetim.

6.2 Palët do të qëndrojnë në kontakt lidhur me çdo aksidenti që do të hetohet nga institucionet kompetente me qëllim që:

a) të shmangin dyfishimin e panevojshëm të përpjekjeve

b) të kërkojnë të bien dakort për të dhëne kontributin e tyre mbi procedurat e hetimit

6.3 Palët janë në dijeni të proceseve hetimore të njëri-tjetrit dhe secili do të luftojë për të shmangur ndërhyrjet në kompetencat e njëri-tjetrit.

6.4 Sa më shpejt të jetë e mundur pas fillimit të një hetimi nga prokuroria ku ka gjasa të jenë të rëndësishme për OKIIA, IND do të kërkojë që prokuroria të kërkojë IML me vendim, se OKIIA dëshiron të këshillohet (t'i merret opinion) për çdo rast që IML mund të përgatis një akt ekspertimi sipas rastit të kërkuar .

7 ÇËSHTJE LIDHUR ME VENDNGJARJEN E AKSIDENTIT

7.1 Aktiviteti i personave që do të ndihmojnë IML në identifikimin dhe largimin e personave të vdekur në një vend aksidenti, janë të përcaktuara në legjislacionin përkatës, Ligji Nr .7830, datë 15.06.1994, "Për Autopsinë" , Kodi i Procedurës Penale i përditësuar me praktikën gjyqësore dhe Rregulloren e Institutit.

7.2 IND pranon që është e arsyeshme që IML dhe stafi i tij ose ata që po e ndihmojnë kjo e bazuar në vendimin e organeve që kanë të drejtën e hetimit shkojnë në vendngjarje në mënyrë që IML të kryejë detyrën e tij më së miri në përputhje me ligjin.

7.3 Të dyja Palët bien dakord për mbrojtjen dhe ruajtjen e provave në vendngjarje bazuar në legjislacionin në fuqi derisa çdo palë të ketë kohën e mjaftueshme për të kryer ekzaminimin e plotë të rastit.

7.4 Përveç rasteve që referohen në pikën 8 të këtij MB, personat që ndihmojnë nuk duhet të lëvizin asnjë provë dëshmuese), Mjeku ligjor pritët të mos veprojë ose të trajtojë të gjitha sendet (dëshmuese ose çdo lloj tjetër), duke përfshirë çfarë do pajisje regjistrimi, pa lejen e personave kompetent.



7.5 Aty ku është e nevojshme të prishen provat me qëllim heqjen e trupave nga rrënojat, sipas legjislacionit në fuqi, aty ku është e mundur, pritet që personat të cilët ndihmojnë IML të regjistrojnë të dhënat para se të ndërmarrin këto veprime dhe t'ia vënë në dispozicion IND ose OKIIA.

7.6 Të dyja palët bien dakord se para se provat e secilës palë të hiqen nga vendngjarja për shqyrtim ose testim të mëtejshëm, IND dhe IML do të njoftohen si me natyrën e përgjithshme të ekzaminimit gjithashtu edhe me rezultatet e tij, bazuar në legjislacionin e vendit.

7.7 IML bie dakord, konform legjislacionit që do të vërë në dijeni IND si për natyrën ashtu edhe për përmbajtjen e sendeve personale si për shembull, ilaçe, syze, dokumentacioni, ditarë, telefonat celular, etj, të cilat janë gjetur tek personat e vdekur dhe që janë larguar nga vendngjarja së bashku me kufomat. **(për sendet personale të kufomave mbahet procesverbal)**

7.9 IND do të njoftojë IML kur OKIIA do të heqë bllokimin e vendngjarjes.

8. AKSESI I PROVAVE TË MBROJTURA ME URDHËR

6.1 Kur ka një urdhër për mbrojtje provave në një vendngjarje aksidenti, për shembull, për parandaluar largimin e regjistruarit fluturimit nga rrënojat, aktivitetet e atyre personave që ndihmojnë IML në identifikimin dhe largimin e personave të vdekur në vendin e aksidentit, mbulohen nga legjislacioni në fuqi.

Kjo do të thotë se nuk është e nevojshme të merret leje nga IND për të prishur provat në bazë të urdhrat të mbrojtjes, duke siguruar që veprimet e personave që ndihmojnë IML ishin të nevojshme për identifikimin dhe largimin e personave të vdekur bazuar në legjislacionin e RSH.

9 AKSESI I PROVAVE FIZIKE NGA TË DY PALËT

9.1 Në raste të veçanta IML, për qëllime hetimi, i kërkon me shkrim OKIIA, provat fizike që mbahen nga OKIIA sipas legjislacionit në fuqi:

OKIIA bie dakort të vërë në dispozicion të IML provat fizike për aq sa e lejon ligji duke:

a) i siguruar materialin në bazë të një kërkesë nga IML kur ky material nuk i nevojitet më OKIIA.

b) i siguruar akses të materialeve për vëzhgimin /vlerësim nga IML nën mbikëqyrjen e IND, duke përfshirë krijimin e mundësisë për IML që të shohë testimin dhe ekzaminimin e kryer ose koordinuar përmes OKIIA

9.2 OKIIA do të informojë IML atëherë kur OKIIA synon që të ndërmarrë ekzaminimin e provave fizike bazuar në legjislacionin përkatës që mund të ndryshojnë statusin apo funksionimin e këtyre provave .

10 AKSESI I IML NË OBR



10.1 Në rast se IML i nevojitet akses në OBR për qëllime hetimi, atëherë IML duhet ti drejtohet Drejtorite të Përgjithshëm të OKIIA me një kërkesë me shkrim në mbështetje të ligjeve në vend.

11 AKSESI I IML NË INFORMACIONE TË REZERVUARA

11.1 Në rastet kur kërkohet akses në informacion të rezervuar , një kërkesë me shkrim ku ka një përshkrim të detajuar të llojeve të informacionit të kufizuar që është duke u kërkuar duhet të dërgohet tek Drejtori i Përgjithshëm i OKIIA, i cili përmbush atë sa është e mundur nga kjo kërkesë, sipas ligjislacionit në fuqi. Një kërkesë e përgjithshme për "të gjitha informatat në zotërim të OKIIA nuk do të merret në konsideratë.

11.2 OKIIA do të përpiqet që të mbaj të informuar IML, atëherë kur të jetë e mundur, mbi ecurinë e hetimit të OKIIA dhe llojet e informatave që janë marrë nga OKIIA (duke përfshirë informacionin që është planifikuar të mblidhet), gjatë një hetimi të OKIIA me të cilin lidhet një hetim i IML bazuar në ligjet e RSH

12 PATHOLOGJIADHE TOKSIKOLOGJIA

12.1 OKIIA pranon se IML do të vazhdojë të ketë rol kryesor dhe kontroll në lidhje me trupat e vdekur dhe çdo autopsi, si dhe analizat toksikologjike që mund të ndërmerren për të konstatuar me fakte shkencor shkakun e vdekjes.

12.2 Ndërsa ndërmarrja e kësaj pjese ndihmon në përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare të RSH-së sipas Aneksit-13 të Konventës së Çikagos (paragrafi p.sh. 5.9), ato nuk janë ekskluzive ndërmjet OKIIA dhe IML. Kuptohet që IML do të vihet në lëvizje vetëm me vendim të organit hetues.

12.3 Me përjashtim të rrethanave të jashtëzakonshme, me vendim të institucioneve kompetente IML do ti sigurojë OKIIA kopje të të gjitha akteve OKIIA do ti konsiderojë si informacione të klasifikuar sekret.

12.4 IML do të kërkojnë të lehtësojë dialogun, sa më shpejt të jetë e mundur, në çdo situatë midis Mjekut-Ligjor dhe IND lidhur me çfarë testimi dhe hetimi mund të jetë i dobishëm në raste të veçanta duke përfshirë këtu që kërkesat e IND të plotësohen. IND do të pajisë Mjekun Ligjor me një portret të asaj çka IND po kërkon dhe se çfarë i nevojitet.

12.5 IML gjithashtu do të përpiqet të përshpejtojë testimin dhe sigurimin e raporteve OKIIA për të mundësuar përfundimin e investigimit, sipas ligjeve në RSH, për raportet toksikologjike IML do të informojë IND , sipas legjislacionit në fuqi, për kohën kur janë marrë mostrat, kushtet e mostrave në momentin e marrjes dhe si ato ishin ruajtur para dhe pas ekzaminimit.



12.7 Aty ku për mungesë burimesh apo ekspertize, kërkesa të rëndësishme specifike të IND nuk janë plotësuar, IML do ti mundësojë OKIIA kopje të të dhënave të nevojshme dhe mostra në mënyrë që OKIIA të konsultohet me një specialist. IML i kërkohet kjo aq ska kuadri ligjor e lejon.

13.KOORDINIMI

13.1 Personi i kontaktit në OKIIA për zbatimin e këtij MB është:

Arben XHIKU

Kryetar Bordi/Drejtor i Përgjithshëm

Rr. "Pashko Vasa", P. 18/6, Tiranë, Shqipëri

P.O.Box: 74

Tel.: +355 4 224 4474; Mob.: +355 69 20 23 153

Fax: +355 4 224 4473

E-mail: arben.xhiku@okiia.gov.al

13.2 Personi i kontaktit në IML për zbatimin e këtij MB është:

Dr.Shk. Bledar XHEMALI

Drejtor

Rr: E Dibrës, Nr 370, Tiranë.

Tel.: 04 2345822 (Zyrë) 0694112542

Fax: 04 4200161

E-mail: bledar.xhemali@mjekësialigjore.gov.al

14. PRINCIPET BAZË TË MB

14.1 Palët sigurojnë që do të ndërmarrin hapa të arsyeshëm që i gjithë stafi i tyre të familiarizohet me termat dhe kushtet e këtij MB.

14.2 Palët mund ta ndryshojnë këtë MB në çdo moment duke rënë dakort midis tyre. Çdo ndryshim duhet të bëhet me shkrim dhe do të jetë një shojcë e këtij MB dhe hyn në fuqi në datën që bihet dakort në shtojcë.

14.3 Secila palë në çdo moment mund të shprehë me njoftim me shkrim qëllimin e saj për prishjen e këtij MB. MB do të përfundojë në datën e caktuar në njoftim.

14.4 Ky MB hyn në fuqi menjëherë në datën që nënshkruhet nga të dy palët

Drejtor i Përgjithshëm i OKIIA:
Dipl.Ing. Arben XHIKU



Drejtor i Përgjithshëm i IML:
Dr. Shk. Bledar XHEMALI



N^o 104 Prot. datë 14.12.2016